

Trebeshina


VITI XXVI
Nr. 105 PRILL 2026

Drejtor:
Bashkim BRAHIMI

Kryeredaktor:
Veledin DURMISHI

Çmimi: 50 lekë

Vendlindjes sime



Nga Valentina Telhaj


Buz, Tepelenë, një emër i vogël në hartë, por një botë e tërë në kujtesë. Aty ku mali flet me heshtje dhe era bart histori, lindin njerëz që e mbajnë shpirtin të fortë dhe zemrën të butë. Vendlindja nuk është thjesht një hapësirë; është një ndjenjë që të ndjek kudo, një zë i brendshëm që të thërret edhe kur je larg. Në Buz, jeta është ndërtuar mbi gurë të fortë dhe mbi parime të palëkundura. Shtëpitë e vjetra, të mbështetura në njëra-tjetrën, nuk janë vetëm mure; janë kujtesa të gjalla të brezave që kanë jetuar me nder, me besë dhe me një ndjenjë të thellë përkatësie. Aty mësohet që fjala ka peshë, që buka ndahet me miq dhe që njeriu vlen për atë që jep, jo për atë që merr. Traditat nuk janë thjesht zakone të trashëguara; ato janë mënyra si shpirti kolektiv mbijeton në kohë. Një këngë e vjetër, një dasmë me valle, një mik i pritur me zemër të gjitha këto janë forma të një kulture që nuk dorëzohet përballë harresës. Në këtë kuptim, Buz nuk është vetëm një vend, por një identitet i gjallë ne vazhdimsi. Psikologjikisht, vendlindja është themeli i asaj që bëhemi. Nga rrugicat e ngushta dhe lojërat e fëmijërisë, deri te këshillat e pleqve dhe sytë e lodhur të prindërve, formohet një hartë e brendshme që na udhëheq gjatë gjithë jetës. Edhe kur largohemi, një pjesë e jona mbetet aty në gurët, në aromat, në kujtimet që nuk shuhen. Antropologjikisht, Buzi përfaqëson një mikrokozmos të vlerave shqiptare: qëndresën, mikpritjen, solidaritetin dhe respektin për rrënjët. Në një botë që ndryshon me shpejtësi, këto vlera janë busulla që na rikthen te vetja dhe

ndoshta kjo është arsyeja pse vendlindja nuk plakët kur rë. Ajo jeton në çdo rrëfim, në çdo mall, në çdo kthim, qoftë edhe vetëm me mendje. Sepse Buz nuk është thjesht aty ku kemi lindur; është aty ku vazhdojmë të jemi, pa varësisht distancës gjeografike. Në fund, vendlindja është një premtim i heshtur që sado larg të shkojmë, gjithmonë do të kemi një vend ku zemra kthehet.



Pamje nga Buzi

**EQEREM XHELLI -
NJË PERSONALITET
I NDËRTUAR MBI
TRASHËGIMNË,
PUNËN DHE
GUXIMIN**



Nga Feti Zeneli

Faqe 7-8

**NË MARICAJ, PËR
FISIN SERANAJ QË
PËRJETUAN
PERSEKUTIMIN
E THELLË
KOMUNIST**



Nga Veleddin Durmishi

Faqe 2-3

**PËR NE,
INXHINIERËT
E SHPIRTRAVE
NJERËZORË**



Nga Asim Brahimi

Faqe 5

**TË DËGJOSH
APO TË
SHOHËSH....?**



Nga Lefter Çibuku

Faqe 3

**NË 100-
VJETORIN E NJË
RRUGE ENDE TË
PA PËRFUNDUAR**



Nga Xhezo Cana

Faqe 6

**BUZI -
PASURIA, JETA
DHE SFIDAT E
NJË KRAHINE
QË PRET TË
ZGJOHET**



Nga Juliana Muçi


Faqe 6

**ISO E FËMIJËRISË
- MISION I JETËS
SË VIKTOR ALIUT**



Faqe 4-5

**POEZI
NGA BEDRI
KABASHA**



Faqe 7

NË MARICAJ, PËR FISIN SERANAJ QË PËRJETUAN PERSEKUTIMIN E THELLË KOMUNIST



Nga Veledin Durmishi

Komunistët që zotëruan kryet e vendit në mbarim të luftës së Dytë Botërore. përfundimisht instaluan diktaturën e proletariatit dhe, për të përjetësuar pushtetin e tyre, morën gjithfarë masash deri edhe më represivët, duke mbjellë frikë, terror e kështu vendosën diktaturën sipas modelit të huazuar nga Bashkimi Sovjetik. Dhe represioni u shtri së pari mbi ata që dolën kundër luftës çlirimtare, pastaj ndaj tregtarëve të qyteteve e fshatarëve të pasur. Shteti ishte diktaturë e proletariatit dhe të gjithë duhej të ishin proletarë; shteti ishte kundër të pasurve e të gjithë duhej të ishin të varfër. Tregtarëve iu morën florinjët, iu sekuestruan punishtet, dhe më pas, kur filloi reforma agrare iu kthyen fshatarit me të njëjtën formulë. Duhet vendosur diktatura, duhej injektuar frika deri në gjak te fshatari, pasi aty ishte edhe 80% e popullsisë, edhe pse kjo popullsi fshatare ishte edhe kontigjenti kryesor i radhëve të ushtrisë çlirimtare. Modeli dihej: Bashkimi Sovjetik. Madje edhe termi për të etiketuar të pasurit e fshatit ndaj të cilëve duhej të vepronte diktatura, ishte një term sovjetik "Kulak" që e përkthyer do thotë fermer me të ardhura të larta. ndërsa në xhargonin e përditshëm etiketoheshin "të cilësuar" Ky term u përdor në fillimet e rënies së Perandorisë ruse dhe ishte "shkopi" i dhunës të cilin Stalini e përdori për të nënshtruar fshatarët e pasur. Të njëjtën politikë ndoqi edhe komunizmi me fshatarët në Shqipëri. Ajo i konsideronte fshatarët e pasur kundërshtarë të kolektivizimit të bujqësisë e blegtorisë. Komunizmi është terror në thelbin e vet. Mbrojtja e pushtetit e përjetësimi i tij kërkonte mjetet e veta represive të cilat komunizmi gjithandej i përdori me efikasitet të plotë. Së pari në çdo fshat duhej të bëhej një kulak. Duhej të ishte një tabelë ku të goditej e keqja që përfaqësonin ata, fshatarët duhet të mermin frikë nga represion që pushteti shfaqte ndaj komshiut i cili u shpall kulak. Shinjestrat ishin graduar mirë: Luftë e hapur, nëpërkëmbje, izolim social, heqja e kartës së frontit, tatim i lartë, punërat më të vështira, privim nga shkollimi, e kështu ky kontigjent fshatarësh ndjeu persekutimin më të thellë. Konsideroheshin armiq të sistemit, shoqërisë ndaj të cilëve tehu i luftës së klasave duhet të jetë i ngritur. U morën pronën fillimisht, bagëti, toka, duke i detyruar të regjistroheshin në kooperativë- model ky i huazuar nga sistemi i Bashkimit Sovjetik. Asnjëherë nuk është shkruar për këtë familje të persekutuar nga sistemi komunist. Eshhtë detyrimi ynë që nëpërmjet fakteve të sjellim edhe pjesë të kalvarit të tyre e njëherazi të sjellim te brezat vuajtjet që të parët kanë përjetuar nga një sistem që sistematikisht i vrau, i persekutoi njerëzit, madje edhe më besnikët e

vet. "Urrejtja e verber ushqehet me gjithfare gjerash te vogla." Fjala "lin" që për vite të tëra i kishte mbushur me aq entuziazëm, tashmë po zvetënohej shpirtit të njeriut të thjeshtë. Pastaj vinte fjala "lumturi" e cila nuk gjeti kurrë strehë në familjet shqiptare. E vërtetë ishte dhimbja.

Dhe tehu i kësaj lufte zbriti në Tepelenë dhe u ngjiti në fshatin Maricaj. Dikush ndërtoi ndonjë listë me dy-tre familje me toka e blegtori. Kështu edhe në Arrëz, në Mezhgoran, Buz e kudo. Dhe në listë u vendos një familje në krye të fshatit. Seranajt ishin vërtet edhe gjeografikisht në krye të fshatit, aty në një hije të Shëndëllisë, por ishin edhe në krye të të pasurve të fshatit. Zotëronin toka të shumta dhe bagëti. Nuk i kishin grabitur askujt asnjë pëllëmbë tokë e asnjë kokë dele. Në regjistrimin e vitit 1946, regjistrimi i përgjithshëm, familja Serani doli me pasuri të mëdha në 20 fshatrat e zonës së Buzit Dhe këtu ishte vija e parë e kuqe që kjo familje do të ishte edhe objekt goditjeje për pushtetin e ri komunist. Kishin 400 krerë të imta dhen e dhi, dy pendë qe, mushka, kuaj, 50 ha kullotë, 8 ha tokë arë e cila shtrihej kryesisht në kurizin e Shëndëllisë, poshtë fshatit Vagalat. Nga erdhi kjo pasuri? Fis punëtorësh, malin e kishin mbi kokë, por pasuria më e madhe ishte e falur. Një kushuriri i tretë i Sulos që e quanin Rrapush nuk kishte fëmijë e që adaptoi një djalë, Mançon. Mançua nga ana e tij kishte dy vajza, por për të përjetësuar mbiemrin dhe për të lënë pasurinë adoptoi djalin e vogël të Sulos, Temen. Rrapushi kishte emigruar shumë vite në Turqi dhe gjithë pasurinë e tij në para e bëri mall kryesisht në toka e bagëti, pasuri që u shtua nga viti në vit. Pra pasuria e sekuestruar në vitet e socializmit ishte e dhuruar nga një kushuri i Sulos. Këtu qëndron ana ekonomike që i vuri seranajt në rreth të kuq.

Kush ishte Bilo Sulo Serani?

Ishte djali i madh i Sulos. Një trup i gjatë prej atleti, i gjallë, dinamik, inteligjent, njeri me inisiativë e që fillimet e jetës së tij i pati të trazuar. Ishin kohë të vështira e trazimi i tyre i bëri shumë njerëz të mos orientoheshin



Bilo Serani

si duhej në rrjedhat e kohës. Ai lindi në vitin 1903 dhe ndahet nga jeta në vitin 1977. Ishte 29 vjeç kur regjistrohet në xhandarmërinë e shtetit të kohës. Ishte viti 1932. Nga kërkimet në arkivin e shtetit gjejmë se mes mbretërisë shqiptare dhe qeverisë italiane, ishte një marrëveshje nga e cila, përgjatë viteve 1925 deri në vitin 1939, shumë trupa xhandarmarie të mbretërisë shqiptare do të ushtronin një kurs disa mujor specializimi. Në këto kontigjent ishte edhe Bilua për nëntë muaj rresht ku mësoi mirë edhe

gjuhën italiane. Në arkiva gjen vetëm emra kursantësh që në vitet më pas lanë gjurmë të thella në politikën dhe ushtrinë shqiptare. Gjashtë vjet në Lezhë e në lballë të Pukës, pastaj dy vjet në Lushnjë. Pushtimi fashist i Atdheut kishte sjellë indinjatë të madhe në shpirtin e shqiptarëve, mbreti qe arratisur dhe kjo forcë rendmbajtëse ishte çorganizuar krejt. Xhandarmaria e Mbretërisë së Ahmet Zogut u shpërbë më 10 maj 1939. Kontigjenti i trupave mbetën pa status, pa uniformë, pa struktura komanduese. Më 18 shtator 1939 Jakomoni, mëkëmbësi i mbretit të Italisë, nënshkroi dekretin për krijimin e milicisë fashiste. Në këto vite Shqipëria funksiononte si mbretëri e Italisë me qendër të kontrolluar nga Roma e kryeministër për vitet 1939-1941 ishte Shefqet Vërlaci, një qeveri kolaboracioniste nën autoritetin e Italisë.



Lagja Seranaj

Kështu ndodhi edhe në Vlorë. Postat u mbyllën, armët u dorëzuan, personeli u shpërbë, Vlorë që historikisht kishte qënë një qytet bazë strategjike e politikës së madhe italiane, Vlorë që kishte dinamika të veçata, sepse ishte edhe pikësynimi i italianëve në kohëra, u bë shpejt edhe baza e antifashizmit në Shqipëri.

Grupimet e para që ndërtuan edhe çetat e para, lindën në malësinë e Vlorës ku edhe dinamika e fashistëve ishte më e gjallë.

Një thirrje e brendshme i njoftonte të gjithë se duhet të mblidheshin në Vlorë, në Sevaster për të parë edhe të nesërnen e kësaj force të madhe luftarake. Dhe ishin 1 500 xhandarë e po kaq edhe ushtarë që prisnin dikë të vinte për të biseduar. Një makinë e vogël me flamurin shqiptar erdhi në Sevaster dhe ishte Ali Rizai i cili mori kontakt me trupat e shpartalluara. Ali Rizai ishte një njeri aktiv i cili në zonat e Vlorës mbante gjallë rezistencën e luftës kundër fashizmit Ai u bëri thirrje që duhet të bashkoheshin me lëvizjen për çlirimin e atdheut. Dikush tha që duhet të zëmë Urën e Mifolit e të mos lejojmë lëvizjet e fashistëve drejt Jugut, por Aliu kundërshtoi duke thënë qartazi se tani Shqipëria ishte pushtuar. E shqiptarët, që i kishte tradhtuar edhe mbreti, nuk u mbetej asnjë rrugë tjetër veç ruga e luftës për çlirim. Bilua kthehet në Maricaj pa menduar dot për të nesërnen e jetës së tij. Do të rrinte në fshat duke i shërbyer pronës apo do të kërkonte të organizohej në shërbimn e vet ishtarak? Dy muaj ndenji në fshat dhe atë vjeshtë i vjen një urdhër që duhet të paraqitej në Lushnjë, në shërbimin që kishte qënë.

Këtu duhet theksuar dilemat

e mëdha që ndjenë këto trupa. Një pjesë iu inkuadruan trupave partizane, shumëkush u bë pjesë e Ballit dhe llegalitetit më pas, një pjesë qëndruan neutralë duke u marrë me punët e tyre, ndërsa një kontigjent u inkuadrua në strukturat fashiste, pa një status të veçantë. Pjesë e këtij kontigjenti u gjend edhe Bilua i cili kishte një përvojë të mirë në këtë armë, kishte një formim profesional të arrirë për shkak edhe të një kursi nëntëmujor në Itali si dhe njohjes i mirë i gjuhës italiane.

Ishte një ndërmarrje individuale. Italia fashiste që kishte qëllime të larta e të largëta ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve, vendosi të rekrutojë nga radhët e ish xhandarëve të cilët mendonte se mund t'i përdorte edhe si prapavijë e qëllimeve të veta.. U bënë thirrje. Ata kërkuar të rekrutoni ish xhandarë të cilët kishin një përvojë dhe më tepër njohnin gjuhën e tyre.

Hysni Kapos e në emër të tij i kërkoi përkthyesit që duhet ta ndihmonte lëvizjen duke nxjerrë jashtë Vlorës një kamioçinë me armë drejt ullishtes së Vlorës. Studenti i kërkoi besën shqiptarit në emër të atdheut, madje edhe i shprehu edhe pasojat që do të kishte ai nëse e tradhtonte këtë çështje. Bilua u mendua një hop dhe i premtoi djalit se do ta ndihmonte. Mjeti i transportit do të vinte aty në orën 12, orë kur ushtarët italianë hanin drekën dhe kishte një mundësi kalimi. Shoferi ishte një djalë i ri elbasanas, ndërsa mjeti lexonte "VL Cerkovina" Dhe erdhi çasti. Mjeti erdhi, Bilua bëri sikur kontrollonte dhe i dha shenjë ushtarit të ngrinte trarin. Mjeti u largua. dhe disa ditë vazhdoi kjo ngarkesë armësh të dilte nga Vlorë për të paisur partizanët me armët e një lufte të madhe çlirimtare. Por kjo lëvizje ra në sy. Atëhere Bilua vrapoi në Skelë. takoi djalin duke i thënë se plani ishte zbuluar e se tani fillonte rreziku. Dhe viti 1942 shënon edhe fundin e karrierës së Bilos në xhandarmërinë e shtetit shqiptar. Dhjetë vjet në atë detyrë.

E atëhere Bilua, u detyrua të kthehet familjarisht drejt vendlindjes. Qëndrimi në Vlorë iu duk i rezikshëm. Kishte një djalë gjashtë vjeç (Dariun) dhe gruan shtatzënë. Shtatë mushka ngarkuar me orënditë e familjes u nisën drejt Tepelenës. për t'u vendosur përfundimisht në Maricaj.

Në tetor të atij viti, 1942, lindi fëmija i dytë, Shefqeti. Gazetën nuk e ndante nga syte Bilua. Ai e ndjeu herët rrezikun që mund t'u kanosej. Së pari pasuria e tyre.

E kaluara e tij, edhe pse ai nuk e ndjente t'i kishte dhënë një ngarkesë negative, sepse ai asnjëherë nuk i doli luftës kundër, përkundrazi, ai ndihmoi aq sa mundësi i dha pozicioni, por ai po e parandjente se pushteti i ri do t'i ndante njerëzit " këta janë tanët e të tjerët janë kundërshtarët, në mos edhe armiqtë tanë." Vëllai i vogël, ish partizan, mund të ishte një mburojë, por situata, si rrodhi më pas, u doli nga duart.

Kush ishte Teme Sulo Serani?

Ishte djali i vogël i Sulos. Atë e birësoi Mançua që kishte vetëm dy vajza, por përjetësimin e mbiemrit e kërkoi te një nip (jo shumë i afërt) duke i dhënë atij pasuri e cila nga viti në vit erdhi duke u shtuar. Kur në fshat erdhën përfaqësuesit e partisë komuniste, ai u rreshtua në brigadën e tetë partizane, duke luftuar në shunë beteja, madje ishte edhe nga ai kontigjent që vijoi luftimet edhe jashtë territorit të Shqipërisë, në Mal të Zi e në Kosovë. Ishte ndoshta një nga partizanët që luftoi gjatë. Në Bosnje ka kaluar monente të vështira jetë, por mbijetoi vetëm falë një familjeje boshnjake e cila e mbajti për 20 ditë në shtëpi duke i dhënë qumësht lope. Kthehet në fshat me dekoratat e luftës. Ishte nga ai kontigjent që pas çlirimit, morën edhe frenat e qeverisjes vendore. Ishte sekretar partie, dikur edhe kryetar i këshillit. në zonë rreshtohet ndër njerëzit që kishin merita nga e kaluara e vet. Ata kishin mbi supe vitet e luftës së madhe dhe u munduan të orientoheshin në Shqipërinë e re që lindi pas vitit 1944. Tani në fshat ishin të tre vëllezërit. Bilua, i madhi, që kishte ardhur nga xhandarmëria e Vlorës, por që edhe në fshat ishte pjesë aktive e çetave teritoriale që



TË DËGJOSH APO TË SHOHËSH....?



Nga Lefter Çibuku

Njerëzit në raport me natyrën dhe veten e tyre e kanë të nevojshme dhe të domosdoshme procesin e të dëgjuarit dhe të parit. Të dyja këto procese janë fizike e biologjike, por në mjaft raste përfshihet dhe procesi psikologjik. Procesi i të dëgjuarit përfshin vëmendjen, kuptimin dhe interpretimin e mesazhit që duhet të përcillet. Në vetë të dëgjuarit ndërthuret përveç procesit fizik dhe të dëgjuarit me vëmendje që lidhet me procesin e ndërgjegjes që gëzojnë qëniet njerëzore. Të parit është kuptimi i asaj që shohim dhe interpretimi sipas përvojave personale të njerëzve të ndryshëm. E theksojmë

këtë pasi ka raste kur sheh zemra dhe jo syri-thotë gjykimi popullor. Në të gjitha rastet, kur njerëzit shikojnë, vështrojnë e vrojtojnë, përpiqen të mos shtrembërojnë të vërtetën, por jo gjithmonë arrihet kjo. Pikërisht se janë dy procese thellësisht njerëzore, prandaj bëhen objekt gjykimi në shoqëri. Le të zbrisim në planin konkret: Në një biznes fason, ku ngarkesa njerëzore është relativisht e madhe, dikush kishte marrë rolin e të çuarit të informacionit tek drejtuesit. Informacioni vinte hera-herës i cinguar dhe i paqartë. Diku shfaqeshin dukshëm shenjat e pasigurisë dhe deri te gënjeshtra. Elementi që mbarte te pasigurtën me vete, u paraqit tek drejtuesi i fasonit. Filloi të lëshonte breshëri fjalësh, që për një njeri të zakonshëm mund të merreshin si të vërteta.

Por eksperiencia e gjatë i dha të drejtë shefit që të pyeste: - po mirë, ti i ke dëgjuar apo i ke parë vetë këto që po më thua?

Bashkëbiseduesi pohoi se i kishte dëgjuar.

Shefit vetëtimthi i erdhi në mendje shprehje dhe qëndrime të gjykit popullor për këtë proces.

- Fol, fol se nuk po të dëgjon njeri.- nga një vesh më hyn e nga tjetri më del. Vetëm veshët e mi besoj. Pikërisht këtu ndaloi logjika e shefit për t'i bërë një pyetje atij që abuzonte me ato që thoshte për të shtëmbëruar realitetin dhe të vërtetën.

- A dëgjove vetë gjë nga këto që po më thua,- iu drejtua shefi tipit në fjalë, duke ngritur tonin më lart

-Po ke dëgjuar, a ka patur të tjerë aty afër?-Cili është reagimi i tyre?

Abuzuesi u tulat dhe sytë po i picërronin, pasi nuk e mendonte se shefi do të mbante këtë mendim. Goja po i bënte naze dhe nuk po mundte të artikullonte asnjë fjalë. Fytyra po i skuqej dhe shikimi po i mjegullohej. Arriti të provonte te vetja se sa gabim kishte bërë, kur urtësia popullore e kishte këshilluar më së miri që të mos dëgjonte fjalët që thonë të tjerët! Mendo shtatë herë dhe prit një herë! Lidhur me procesin e të parit fizik po ashtu edhe biologjik, njerëzimi ka krijuar praktika interesante si në gjykimin e fenomeneve, ashtu edhe analizën e tyre. Në një fshat

malor diku ishin përhapur thashet-heme për teprim sjelljeje midis dy të rinjve; punëtorit dhe brigadierit. Gumëzhinte fshati, por te veshi i atyre që jepnin konsiderata dhe gjykimi, ose pafajësi, nuk kishte arritur. Syri dhe mendja gjykon. Nuk mund të analizohet një veprim që sjell pasojat të rënda, pa parë më herët shkaqet dhe pasojat që rrjedhin. Çdo njeri që ngre një problem, duhet të ketë parasysh stigamtizimin e tij, të parët në vend të gjësë se sa më larg syrit dhe të gjykuarit të jesh, aq më tepër, aq më e paqartë bëhet situata. Në këto raste duhet t'i mëshojmë shumë të gjykuarit me paritet.

Përsëri urtësia popullore na rrëfen e na vjen në ndihmë se sa më larg syrit të jesh, aq më larg zemrës ndodhesh. Fjalët kur lëshohen qesisht, përhapen aq shpejt sa nuk ka asnjë mundësi teorike e praktike t'i mbledhësh ato. Kjo është kaq e vërtetë sa dhe gjykimi popullor shpesh i stigmatizon në "syrin e keq" i cili ka aftësi tejet verbuese. Kur veprimet e dy të rinjve iu nënshtuan logjikës dhe gjykimit njerëzor, gjërat venë normalisht në shtratin e vet real.

Kështu ndodh kur shihen gjërat me "syrin me xham dhe jo me atë pa xham"

Të dëgjuarit dhe të parit janë procese që kanë një shinë të përbashkët. Përveç domod-soshmërisë këto përdoren në gjuhën popullore në mënyrë metaforike. Shiko, se syri të gënjen ndonjëherë, kur duam të paragjykojmë e vëmë në lojë lidhjet jonormale martesore, apo edhe në marrëdhënie tregtie të djallëzuara e në marrëdhënie shoqërore. Kuptimplote janë shprehjet "Mos dëgjo llafet e botës, fjalët e këqija hapen si hithri" etj. Nga eksperiencia njerëzore dhe gjykimi popullor të parët konsiderohet më i besueshëm se të dëgjuarit, pasi te këto të dytat lidhen jo rrallë me devijime, të pavërteta e thashetheme, por mos të harrojmë se edhe ajo që sheh mund të jetë e shtëmbëruar, e idealizuar dhe e kapluar nga emocionet.

Të dyja këto procese e ndjekin shoqërinë njerëzore në vazhdimësi, por mbi të gjitha është kuptimi i tyre, interpretimi nga sistemi nervor, pra, të shohësh, të gjykos dhe të kuptosh.

NË MARICAJ, PËR FISIN SERANAJ QË PËRJETUAN PERSEKUTIMIN E THELLË KOMUNIST

vepronin në zona duke i mbajtur ato zona jashtë ndikimit të forcave të Ballit, por edhe ndihmonin lufrat lokale me pushtuesit. Bilua kishte një shkallë të lartë inteligjence, kishte një staturë të lartë, kishte hije në shoqëri dhe gëzonte respektin e gjithë banorëve të zonës. E kaluara i kishte rritur përmasat e një drejtuesi të mirë ushtarak. Ndërsa vëllai tjetër, i mesmi, Fetiu, iu përvesh punës. Tokat dhe bagëtisë kërkonin punë



Teme Serani

dhe punëtorë. Fetiu, por edhe Bilua merreshin me punët e shumta, ndërsa Temja, që ishte bërë komunist në flakët e luftës, merrej edhe me punë pushteti e partie në fshat e më gjerë. Ishte si i thoshin në atë kohë "goja e fshatit" Por ku u këput zemreku i jetës që këtë familje ta fusnin në kalvarin e gjatë të dhunës e urrejtjes?

Mbase një zënkë atje në zyrat e partisë në rreth solli nfrymshimin e raporteve të partisë me Temen. Partia në rreth e kishte thirrur Temen në Tepelenë e atje i komunikuan se ai, si njeri i besuar i partisë, njeri me merita nga lufta, ishte caktuar komandant i një brigade me vullnetarë që do të shkonin në Veri të vendit..

Ndërtohej hidrocentrali "Karl Marks" Partia i shprehu besimin dhe i dha mbështetjen. Por Temja nuk pranoi. Arsyeja ishte pragmatiste.- Unë jam i lodhur, tani kam pasuri dhe duhet t'i shërbej asaj! Ndoshta biseda ngeci diku, por diku edhe u agravua. Njeriu i partisë e kërcënoi ish njeriun e luftës, por edhe njeriu i luftës u mundua t'i përgjigjej me të njëjtën monedhë .

Ndoshta këtu seranajt morën vijën e tretë të kuqe, se e dyta ishte pasuria dhe e para ishin tetë vitet e rekrutimit të Bilos në xhandarmarinë e mbretit Ahmet Zagolli dhe dy vitet e shërbimit në pushtimin fashist në Vlorë. Dhe në vitin 1951 kjo familje u shpall «kulak» për dhjetë vjet rresht Dhe kalvari i vuajtjeve nuk pati të ndalur.

Tatimet ishin shumë të rënda. Një herë u kërkuan 300 kg mish se ushtria ishte pa ushqime.U sekuestruan pasurinë. Nuk ishin të vetëm që do të binin pre e qëndrimit brutal të politikës komuniste. Edhe sot tregohet rasti i sekuestrimit të një tufe delesh në Mogila të Vasjarit. Në Mogila kishin shkuar përfaqësuesit e pushteti për të sekuestruar bagëtitë e një arrëzioti.... Dhe i zoti i kopesë kishte qënë partizan, por edhe përfaqësuesi i pushtetit që kryesonte grupin e që do të sekuestronte bagëtitë, ishte shok i brigadës partizane. Dhe ai i thotë fshatarit se do të sekuestrojmë gjysmën e bagëtive, por, si mik që të kam, hiq të vjetrat, të sëmurat për ne dhe të mirat mbaji për vete. I pabesë u tregua kryetari i ekipit të pushtetit! Fshatari i ndau bagëtitë, por ata morën dhëntë e mira! Fshatari arrëziot mbeti pa frymë, e hëngrën në besë. Ai dhe fëmijtë e tij qanë të balli i shtrungës. Ndjënë dhimbje. Pasuria do të ikte pak nga pak. Ky ishte pushteti i komunistëve të cilët e varfëruan këtë popull deri në zgrip. Kishte filluar dimri komunist, fundin e të cilit askush nuk mund ta para-

shikonte. Lufta e klasave, e nxitur nga fanatikët komunistë të fshatit të cilët kërkonin me të gjitha mjetet ta denigronin, ta poshtëronin duke përdorur të gjitha mënyrat e spiunimit famëkeq. Ata provuan privimin nga jeta sociale, ata përjetuan një denigrim në të gjitha drejtimet, madje edhe kur pas dhjetë vjetësh ata e fituan të drejtën. Denigrimi vazhdoi gjatë deri në agim të demokracisë.

Temja ishte ndarë "de jure" nga vëllezërit. Ndërkohë që i vëllai ishte projektuar për ta cilësuar "kulak". Dhe një natë u ngjiti më Maricaj një i deleguar i komitetit të partisë i cili sillte në fshat fjalën e partisë: Bilua do të cilësohej "kulak" dhe Temja si njeriu i partisë duhet të ndahej nga vëllezërit. Ai quhej njeri i partisë, ndërsa Bilua armik i saj, Temja nuk pranoi të ndahej nga vëllezërit. Cështja u përmblodh: me partinë apo me vëllezërit?! Temja zgjodhi të dytën. Kështu ai u përjashtohet nga partia, u cilësua kulak tetë vjet. Kur kooperativat filluan jetën ekonomike në fshat, Temaj u bë pjesë e tyre e kështu ia hoqën atë cilësim, ndërsa dy vëllezërit e tjerë tri vite më pas.

Dhe në vitin 1961, Bilua që e kishte një "AS" në dorë, vendosi ta përdorë. Madje shumë vonë u kujtua. Ai nuk e kishte harruar atë akt të lartë në Vlorë që ndihmoi jo pak që armët e grabitura nga një depo e fashistëve të dilnin jashtë Vlorës për të armatosur njësitet partizane në qershor të vitit 1942. Dhe shkoi në Tiranë. Kërko me insistim të takojë Hysni Kapon, njeriun numër tre të partisë në ato vite. Pas 15 ditësh ai mund të ndodhej përballë tij. Sigurisht që nuk e njihnin njeri-tjetrin. Bilua fare qetësisht i tregoi për djaln nga Skela e Vlorës që në emër të tij kishte takuar një xhandar në vitin 1942, në vendin e quajtur "Pusi i Mezinis" i cili i kishte ndihmuar disa ditë rresht të nxirrin një makinë me armë jashtë Vlorës. Makina mbante

shkrimin "VL Cerkovina" - E ai, xhandari që mundësoi aksionin tuaj, ishte një burrë nga Maricaj i Tepelenës, Unë jam ai. Hysni Kapos i mori vëmendjen njeriu që minte në këmbë aty përballë tavolinës. -Si e ke hallin?- e pyeti komunisti i lartë

-Më kanë bërë kulak me pa të drejtë,- doli Bilua te halli i tij që po e mundonte që prej dhjetë vjetësh.

-Shko në Tepelenë se do të të vijë përgjigjja,- i tha Hysni Kapua. Dhe ditë më pas familja e tij mori kartën e anëtarësimit të frontit. Por persekutimi vijoi. Ashtu sikurse është thënë, partia kërkonte ta mbante ndezur gjithnjë luftën e klasave si mjetin më efikas për të mbajtur popullsinë të nënshtuar e pushteti komunist të qeveriste lehtë me ato zgjedhje gjithnje 99%. Edhe pse komunistëve nuk u rrezikohej pushteti, ata, në çdo dekadë, nxirrin një grup armiqësor, sabotator, tradhtar të idealeve komuniste për të justifikuar edhe dështimet e saj në qeverisjen e gjatë 45 vjeçare. Në fshat lufta bëhej edhe më e ashpër. Partia në bazë ishte mbushur me komunistë fanatikë që për idealin e partisë të vrisnin. I privuan nga jeta, i mbajtën larg shkollimit, u jepnin frontet më të vështira të punës, i suvejonin në çdo anë e kështu kalvari i tyre ishte plot privacione. Letra denigruese kundër tyre, prapaskaena që e ndotnin mjedisin e fshatit. Asgjë nuk e ngrohu dot gjysmën e fisit seranaj (gjysma tjetër nuk u persekutua) ku e përditshmja e tyre ishte e lodhshme, deri në raskapitje. Fjalimet, duartrokitjet, parrullat ishin si skenografia e një teatri, ishin maska mashtruese që me gënjeshtat e tyre, komunistët e mbajtën këtë popull në diktaturë plot 45 vjet, një popull të gjuhëzuar, të varfëruar deri në palcë.

Por pse u bënë kulakë njerëzit ë këtij fisi? Dikur fajësonin veten, por dikur e shfajësonin. Shpesh përpiqeshin të mos lëndonin veten tej

atyre vuajtjeve, Se aty kishte me tepri. Ata, si gjithë shqiptarët, ishin dëshmitarë të dhjetra historive, deri edhe tragjike të një populli të tërë që shteti komunist kishte ngritur atë "shtratin e Prokustit" brenda të cilët duhet të rrinin shqiptarët. E kjo gjëndje "me apo pa faj" që nuk u solli asnjëherë një rrethanë lehtësuese, i shoqëroi Seranajt deri në pragdemokracie.

Tani është më e lehtë të gjykos. Dariau që sot është 90 vjeç dhe është i kthjellët, jep qartësisht arsyet që të parët e tij u bënë kulakë.

Së pari, vëren ai, nuk u orientuan dot në kohën e re që po vinte, nuk e kuptuan dot se ky ishte rendi i komunistëve, nuk e menaxhuan dot situatën në favor të tyre, na mori në qafë pasuria dhe nuk e kuptuam dot se pushteti i ri ishte armik i të pasurve. Pastaj Bilon e ndoqi pas si një hije e



Dari Bilo Serani

zezë shërbimi në xhandarmërinë e Ahmet Zogut si dhe shërbimi i tij dy vjet në Vlorë në një rreshtim fashist. Sigurisht nuk do të kalonin aq lehtë. Ndërsa Temja nuk iu përshtat dot konjunkturave të kohës,anoi nga pasuria, ndërkohë që pushteti e donte nën shërbimin e vet. Ata nuk e dinin se Gëtja kishte thënë: "Do të jetosh brenda ligjeve sipas të cilave je krijuar. Prej tyre nuk ikën dot."

ISO E FËMIJËRISË – MISION I JETËS SË VIKTOR ALIUT

Nga Feti Zeneli

Ka njerëz që ecin në shumë udhë, por mbajnë në zemër vetëm një dritë. Jeta e Viktor Aliut, e lindur mes gurëve e erërave të Kalivaçit më 1 janar 1962, është dëshmi se njeriu mund të ndryshojë profesione, qytete, përgjegjësi, por nuk ndryshon kurrë thirrjen e shpirtit. Ai ka qenë mësues i historisë dhe gjeografisë, jurist i së drejtës civile, drejtues në administratë e në sektorë të ndryshëm shtetërorë e privatë; megjithatë, mbi të gjitha këto tituj, si një refren që nuk shuhet, qëndron kënga - kënga polifonike labe, që për të nuk është thjesht art, por frymëmarrje.



Një jetë me shumë role dhe "Thesaret Labe"

"Ku këndohet, aty është jeta", thotë një fjalë e urtë popullore; dhe në jetën e Viktorit, kënga ka qenë gjithmonë shenja më e gjallë e ekzistencës së tij krijuese. Në Shtëpitë e Kulturës të Selckës e të Kalivaçit, ai nuk ushtroi thjesht një detyrë administrative, por ringjalli një trashëgimi. Me përkushtim e vizion, ngriti dhe bëri konkurrenca grupet polifonike të Komarit e Kalivaçit, duke i çuar deri në skenat e Festivalit Folklorik të Gjirokastrës, atje ku zëri i Labërisë bëhet jehonë kombëtare. Në çdo funksion tjetër që mbajti më pas - në arsim, në dogana, si administrator biznesi apo në sektorët juridik - ai mbeti njeriu që e mat kohën me ritmin e iso-s dhe e ndien historinë si varg kënge.

Sepse për Viktorin, kultura nuk është sektor pune, por amanet; kënga nuk është hobi, por identitet. Si solist i vlerësuar me çmime, si krijues i mbi 200 teksteve e poezive, si drejtues artistik i suksesshëm në festivale brenda e jashtë vendit, ai ka dëshmuar se pasioni i vërtetë nuk njeh pushim. Kulmi i kësaj rruge është themelimi i grupit "Thesaret Labe" në vitin 2018 - një emër që tingëlloj si program jete - me të cilin ka çuar zërin e Toskërisë deri në diasporën shqiptare në Amerikë, duke dëshmuar se kënga labe nuk është thjesht kujtim i së shkuarës, por frymë që udhëton dhe bashkon. Kështu, nëse do të përkufizohet me një fjalë, jeta e Viktor Aliut

do të ishte ajo që Niçe e shpreh me fjalët: "Pa muzikë, jeta do të ishte një gabim." Për të, muzika nuk është stoli e jetës, por është vetë kuptimi i saj. Dhe pikërisht aty, në këtë besnikëri ndaj këngës, qëndron madhështia e tij e hesh-tur.

Gjatë viteve të shërbimit ushtarak në Sarandë (1982-1983), talenti i tij mori përmasa të reja. Në repartet e Delvinës e Konispolit, ai nuk ishte thjesht ushtar; ishte drejtues artistik, organizator, interpretues i këngës dhe valles labe, duke e kthyer disiplinën e kazermës në hapësirë krijimi. Atje u provua se kënga për të nuk ishte thjesht kujtim fëmijërie, por eksperiencë që e bënte të dallohej, të bashkonte njerëz, të ngrinte moral.

Pas ushtrisë, specializimi në degën e regjizurës ishte një hap i natyrshëm - si të ndiqte një shteg që tashmë ishte hapur brenda shpirtit të tij. Emërimi si përgjegjës në Shtëpinë e Kulturës në Selckë të Madhe nuk ishte thjesht fillim pune, por fillim misioni. Edhe pse kushtet nuk ishin të favorshme, ai e gjallëroi jetën kulturore me energji të pashtershme, ringriti grupin polifonik të Komarit, e pasuroi me elementë të rinj, me repertor të admirueshëm, duke e radhitur ndër më të mirët në rreth e më gjerë. E njëjta frymë e ndoqi edhe në Kalivaç, ku polifonia u bë sërish shtyllë identiteti.



Sepse, në thelb, pasioni i Viktorit nuk lindi nga ambicia për skenë, por nga dashuria për rrënjën; ashtu siç thotë një fjalë e urtë: "Zëri është pasqyra e shpirtit." Dhe zëri i tij, i formuar mes familjes, shkollës, ushtrisë e skenës, është pasqyrë e një shpirti që e gjeti herët thirrjen e vet - dhe nuk e tradhtoi kurrë.

Fëmijëri e ndërtuar mbi iso

Po si lindi ky pasion që do ta shoqëronte si një hije drite gjithë jetën? Si u ndez kjo flakë që nuk u shua as në bankat e universitetit, as në zyrat e administratës, as në uniformën e shërbimit ushtarak?

Ai lindi herët - shumë herët - në atë moshë kur fëmija ende nuk di të shpjegojë botën, por di ta ndiejë. Pesë a gjashtë vjeç, një djalë

i vogël në Kalivaç, i rrethuar nga tetë vëllezër e motra, mes zërave që mbushnin shtëpinë si dallgë të ngrohta dimri. Ishte më i vogli, dhe ndoshta pikërisht kjo e bëri më të lirë të dëgjonte, të përthithte, të ëndërronte. Në atë shtëpi, kënga nuk ishte zbukurim; ishte mënyrë jetese. Nëna, me zërin e saj që dukej sikur vinte nga thellësia e shekujve, vëllezërit e motrat që e thurin iso-n me natyrshmëri, dasmat e sebetet familjare ku kënga labe ngrihej si kurorë mbi gëzimin - të gjitha këto u bënë shkolla e parë e shpirtit të tij.

Netët e gjata të dimrit, kur era përplasej në dritare e oxhaku ndizte fytyrat, shndërroheshin në akademi të vogla polifonie. Aty, mes zërave që ndërthureshin si fjet e një qilimi të vjetër, ai mësoi jo vetëm melodinë, por frymën e saj. "Fëmijëria është atdheu i zemrës", ka thënë Rilke; dhe atdheu i zemrës së Viktorit u ndërtua mbi iso. Kënga ishte trashëgimi gjaku, por edhe zgjedhje shpirti. Ajo i vinte nga të parët, por në të njëjtën kohë e thërriste përpara.

Që në klasën e parë e deri në përfundim të tetëvjeçares, ai ishte pjesë e pandarë e grupeve artistike të shkollës. Zëri i tij karakteristika spikati herët: fillimisht si kthyes, pastaj si marrës - dy role që kërkojnë jo vetëm talent, por ndjeshmëri e përgjegjësi. Nën kujdesin e mësuesve të përkushtuar, si Dëro

harrueshme, por njëkohësisht edhe detyrime ndaj saj." Në këto fjalë spikat më shumë se një dëshirë artisti; daklohet zëri i një biri që ndien borxhin ndaj vendlindjes. Sepse vendlindja nuk është vetëm hapësirë gjeografike - është truall kujtimesh, është burim zërash që të thërrasin edhe kur je larg. Siç thotë një fjalë e vjetër urtësie: "Njeriu nuk e zgjedh vendin ku lind, por zgjedh çfarë i kthen atij vendi."



Ideja e festivalit nuk lindi në një tryezë zyrtare, por në heshtjen e mendimit që bluan shpirtin. Ishte një ëndërr që trokiste prej vitesh, por që mbetej pezull për mungesë vullneti institucional. Kishte tentuar disa herë; kishte paraqitur mendime, sugjerime dhe projekte. Por dyert e mbyllura nuk hapen me këngë, nëse mungon dëshira për ta dëgjuar atë. Ata që drejtonin më parë Bashkinë e Memaliajt nuk e shihnin si prioritet, madje nuk e merrnin me seriozitet, një nismë të tillë. Dhe kështu, ideja mbeti si një melodi e painstrumentalizuar, që priste kohën e vet.

Koha erdhi me ndryshimin e drejtimit. Në krye të Bashkisë u zgjodh një njeri i punës, energjik, vizionar dhe bashkëpunues - Albert Malaj - dhe ai që kishte qenë një vullnet i brendshëm, mori formë konkrete. Sepse vizioni ka nevojë për mbështetje, ashtu si kënga labe ka nevojë për iso. Dhe kur këto dy elemente bashkohen, lind harmonia. "Asgjë e madhe nuk arrihet vetëm", thotë një shprehje e njohur; "Jehona e Vjosës" është pikërisht fryt i këtij bashkimi vullnetesh.

Por motivi i Viktorit nuk ishte garë, as dëshirë për t'u rreshtuar mes shumë festivalesh të tjera. "Motivi nuk ka qenë thjesht: ha-jde të bëj një festival edhe unë siç bëjnë të tjerët. Jo, asnjëherë jo, -thekson ai. -Ideja ka qenë e mirëmenduar, e studiuar, e detajuar." Projekti u hartua me kujdes, me vizion afatgjatë, me synim të qartë estetik dhe kulturor. Dhe puna e bërë me seriozitet u kurorëzua me shpalljen fitues nga Ministria e Kulturës për dy vite radhazi, 2024 dhe 2025 - një dëshmi se kur pasioni bashkohet me profesionalizmin, rezultati nuk vonon.

Emri "Jehona e Vjosës" nuk është zgjedhur rastësisht. Vjosa, lumi i fundit i egër i Evropës, është

simbol i qëndrueshmërisë, i rrjedhës së pandalshme, i identitetit që nuk përkulet. Ashtu si lumi që çan shkëmbin me durim, edhe folklori burimor ka mbijetuar shekujsh mes sfidash. Festivali synon të jetë pikërisht kjo jehonë - një thirrje që përhapet nga brigjet e Vjosës në mbarëhapësirën shqiptare, duke rikujtuar se tradita nuk është e shkuara e ngrirë, por rrjedhë e gjallë.

Qëllimi i tij është i qartë dhe

fisnik: promovimi, motivimi dhe ruajtja e trashëgimisë shpirtërore të folklorit burimor. Por mbi të gjitha, transmetimi i dashurisë për këngën e traditat te brezi i ri. Sepse, siç ka thënë Mahatma Gandhi, "Një kulturë jeton për aq kohë sa jeton në zemrat e njerëzve." Nëse ajo nuk mbillet e kultivohet te të rinjtë, ajo zbehet e nuk lulëzon. Fusha e saj është skena dhe spektatorët.

Kësisoj, "Jehona e Vjosës" nuk është vetëm festival; është urë mes brezash. Është hapësirë ku grupet e reja ngjiten në skenë, ku zërat e rinj provojnë performancën e tyre përballë publikut, ku trashëgimia nuk ruhet në arkiv, por këndohet, përjetohet, duartroket. Dhe në këtë nismë, shfaqet edhe një herë thelbi i misionit të Viktor Aliut: jo të mbajë këngën për vete, por ta shpërndajë si dritë. Sepse në fund, siç thotë një fjalë e urtë shqiptare, "Ajo që lë pas është ajo që ke dhënë." Dhe me "Jehonën e Vjosës", ai ka zgjedhur të japë zë, hapësirë dhe të ardhme trashëgimisë që e rriti.

Tradita si investim për të ardhmen

Dhe kur pyetja shtrohet natyrshëm - cilat janë projektet për këtë vit? - përgjigjja nuk është thjesht një listë aktivitetesh, por një vazhdimësi e misioni që buron nga lidhja shpirtërore me traditën dhe me vendlindjen.

"Duke pasur parasysh lidhjen shpirtërore që kam me zonën time, veçanërisht në aspektin kulturo-ro-artistik..." -shprehet Viktori -dhe në këto fjalë ndihet qartë se çdo nismë e tij nuk lind nga rastësia, por nga vazhdimësia. Sepse, siç thotë një fjalë e mençur, "Kush e di nga vjen, di edhe ku shkon." Këtë vit, një nga projektet më domethënëse me të cilat po merret seriozisht Viktori është përgatitja për emisionin

Për ne, inxhinierët e shpirtrave njerëzorë



Nga Asim Brahimi

Kush jam unë që po themi “ne.” Unë jam si ju, qindra e nuk gabohem te them mijëra që jetën ja kanë kushtuar një ideali “mësuesisë.” Ne jemi që po të zihemi dorë për dore mund të rrethojmë teritorin e vendit tonë e më shumë se kaq. Ne jemi ata që nuk kemi lënë shtëpi e kasolle lagjeje e dikush, kur ka patur mundësi, edhe në qytet, të futemi në jetët e këtyre familjeve si pjesëtarë të tyre, por me një “bonus” shtesë: hapjen e një dritareje të paparë për fëmijën e tyre, sepse ne në punën tonë jemi “inxhinierë” të shpirtrave njerëzorë- nxënësve tanë! Bukuri! Ky ishte gëzimi i madh për ata dhe nder i madh për ne që merrnim në duart tona “ato duar të njoma” për t’i drejtuar,

orientuar, ngritur në këmbë e për të nisur rrugëtimin e pafund dhe pastaj fluturimin në hapësirat e pafundme të jetës, sipas prirjeve, mundësive të tyre. Për secilin nga Ne,(më falni për drejtshkrimin me të madhe të fjalës “Ne”), misioni ynë është



jo vetëm i bukur, por edhe madhështor. Për këtë ne mësuesit duhet të ndihemi krenarë për punën tonë, sepse nëpër

duart tona kanë kaluar e kanë dalë me qindra mësues. mjekë, gazetarë, juristë, inxhinierë, agronomë, ushtarakë e plotë e plotë “sinia” me specialitete bashkëkohore. Një mirësi dhe vlerësim për secilin; me ta duhet të krenohemi, për gjithsecilin nga

ata mund të shkruhet e të botohet nesër. Kjo është edhe ndjesia që më nxiti të sjell në vëmendjen time edhe disa prej

vlerësimeve dinjitoze nga figura botërore dhe jo vetëm për vlerat e figurës së mësuesit për të cilat duhet të ndihemi krenarë.

1 - Konfuci, (551-479 p.e.s.) filozof kinez thotë: “Vlera e mësuesit dhe pesha e qiellit nuk maten kurrë!”

2 - Viktor Hygo,(1802-1885) romantiku më i madh francez, autor i shumë romaneve, dramave, lirikave bën këtë vlerësim: “ Dy janë nëpunësit kryesorë të shtetit: nëna dhe mësuesi”

3- Edmon De Amicis,(1846-1908) shkrimtar italian, autor i librit “Zemra” jep këshillën domethënëse” Shqiptojte me nderim emrin “mësues” i cili, pas emrit të prindërve, është më i madhi emër!”

4- Llazar Siliqi, (1924- 2001) poet shqiptar, autor i poemës “Prishtina” “Mësuesi”, shprehet:

*“Edhe kur thinjat do t’na mbulojnë kryet,
do t’sjellim ndër mend një emër nderues,
emrin e dashtun porsì fëmija,
emrin e thjeshtë, por të madh, mësues!”*

Le të jenë këto pak rreshta homazh për punën që kemi bërë dhe për atë që do të bëjmë vijuesit tanë- vizionin e nderuar të mësuesisë.

ISO E FËMIJËRISË – MISIONI I JETËS SË VIKTOR ALIUT

“Gurra Popullore” në Top Channel, ku do të prezantohet treva e Bashkisë Memaliaj me thesarin e saj më të çmuar: folklorin burimor, këngën polifonike, veshjet tradicionale dhe traditat kulinare.

Ky prezantim nuk është thjesht një dalje televizive; është një dritare

thënë Nelson Mandela, “Arsimi është arma më e fuqishme për të ndryshuar botën.” Në këtë rast, arsimit kulturor është ura që lidh të shkuarën me të ardhmen. Synimi është fare i qartë dhe afatgjatë; që kënga polifonike labe të mos mbetet privilegj i brezave të vjetër, por të

jashtë vendit. Synimi mbetet i qartë: rritja e performancës, pasurimi i repertorit, përpunimi më i thellë i interpretimit, duke e çuar grupin në një stad edhe më të lartë profesional. Sepse arti i vërtetë nuk kënaqet me arritjet e djeshme; ai kërkon përmirësim të vazhdueshëm. Siç thotë një fjalë e urtë: “Kush ndalet, mbetet pas; kush punon, përparon.”

Ftesa nga Shkolla Shqipe “Iliria” në Londër për festat e Nëntorit është një tjetër dëshmi se zëri i “Thesareve Labe” po kalon kufijtë gjeografikë. Pas përvojës në Amerikë, edhe diaspora në Britani do të ketë mundësinë të dëgjojë nga afër jehonën e Labërisë. Këto udhëtime nuk janë vetëm koncerte rutinë me prapavijë komercialeë; janë rikthime simbolike të këngës në zemrat e shqiptarëve që jetojnë larg atdheut. Sepse, siç thotë një proverbë e vjetër, “Atdheu është aty ku të rreh zemra.” Dhe kur kënga labe ngrihet në skenat e botës, ajo bëhet urë mes zemrave.

Në fund, projektet e këtij viti dëshmojnë se për Viktor Aliun rruga nuk ka mbaruar; ajo sa vjen e zgjerohet. Ai mbetet besnik ndaj një misioni që e ka nisur që në fëmijëri: të ruajë, të promovojë dhe të përçojë trashëgiminë shpirtërore të vendit të tij. Sepse, në thelb, siç ka thënë Aristoteli, “Ne jemi ajo që bëjmë vazhdimisht.” Dhe ajo që ai bën vazhdimisht është t’i japë zë kujtesës, t’i japë skenë traditës, të argëtoj publikun, të gjallëroj jetën komunitare dhe t’i japë të ardhme këngës.

Një jetë si këngë polifonike

Nëse do ta përmbledhim në një figurë të vetme gjithë këtë udhëtim, do të thoshim se jeta e Viktor Aliut është si një këngë polifonike: me shumë zëra, me shumë role, me ulje-ngritje, por me një bosht të pandryshueshëm harmonie. Ai ka qenë mësues, jurist, drejtues institucioni, administrator; ka kaluar nëpër sektorë të ndryshëm, ka mbajtur përgjegjësi të larmishme - por në thelb ka mbetur gjithmonë këngëtar i shpirtit të vet dhe i shpirtit të trevës së tij.

Sepse për të, folklori nuk është kujtim nostalgjik, por përgjegjësi e gjallë. Ai e ka kuptuar thellë se tradita nuk ruhet duke e vendosur në

por të jetë zë i së ardhmes. Që fëmijët të mësojnë jo vetëm tekstin e këngës, por kuptimin e saj; jo vetëm melodinë, por vlerën e bashkimit që ajo përçon. Sepse polifonia, në thelb, është metaforë e shoqërisë: zëra të ndryshëm që bashkohen për të krijuar harmoni.

Në fund, ajo që mbetet nuk janë titujt, as detyrat e mbajtura, por gjurma e lënë. Dhe gjurma e Viktor Aliut është një gjurmë zëri - një jehonë që nis nga brigjet e Vjosës, përhapet në skenat e festivaleve, kapërcen oqeanin e mbërrin në diasporë, e rikthehet sërish në zemrat e njerëzve si kujtesë dhe krenari.

Siç ka thënë Platoni, “Muzika i jep shpirt universit, krahë mendjes,



e hapur ku një trevë e tërë flet me gjuhën e vet autentike. Është një gur që hidhet në ujë, për të krijuar valë kujtese e krenarie. “Kultura është fytyra e një kombi,” thoshte Faik Konica, dhe në këtë pasqyrë që do të shpalojë, Memaliaj do të shfaqet jo vetëm si hapësirë gjeografike, por si identitet shpirtëror.

Paralelisht, në bashkëpunim me Bashkinë Memaliaj dhe me grupin “Thesaret Labe” në Tiranë, po hartohet një plan i strukturuar për nxitjen e brezit të ri - nxënësve të arsimit nëntëvjeçar dhe të mesëm - drejt njohjes, dashurisë dhe ruajtjes së traditave folklorike. Sepse, siç ka

bëhet frymëzim për të rinjtë; të mos këndohet vetëm nga kujtesa, por nga zemra e gjallë e rinisë.

Në vizionin e Viktorit, kjo nismë nuk është vetëm një projekt edukativ, por një investim shpirtëror. Ai e di mirë se nëse një fëmijë mëson të mbajë iso, ai mëson edhe të dëgjojë tjetrin; nëse mëson të jetë marrës apo kthyes, ai mëson përgjegjësinë dhe harmoninë. Dhe harmonia është themeli i çdo shoqërie të shëndetshme.

Ndërkohë, për “Thesaret Labe”, objektivat e këtij viti janë në rritje - si në cilësinë artistike, ashtu edhe në shtrirjen e aktiviteteve brenda dhe



rafte, por duke e vënë në skenë; nuk mbijeton duke u përmendur, por duke u kënduar. “Një popull që harron rrënjët, thahet si pema pa ujë,” thotë një fjalë e urtë. Ndërsa Viktori ka zgjedhur të bëhet ujë për rrënjët e këngës polifonike.

Në çdo projekt të tijin ndihet qartë një vizion: që kënga labe të mos mbetet vetëm jehonë e së shkuarës,

fluturim imagjinatës dhe jetë gjithçkaje.” Në jetën e tij, muzika - kënga polifonike labe - i ka dhënë jo vetëm kuptim, por mision. Dhe për sa kohë që ai dhe të tjerë si ai do të vazhdojnë ta mbajnë gjallë këtë mision, jehona e këngës sonë nuk do të shuhet.

Ajo do të këndohet. Do të trashëgohet. Do të jetojë.

BUZI – PASURIA, JETA DHE SFIDAT E NJË KRAHINE QË PRET TË ZGJOHET



Nga Juliana Muçi

Në jug të Shqipërisë, në krahinën e Tepelenës, shtrihet Buzi – një zonë që në pamje të parë ofron qetësi, natyrë të paprekur dhe një ndjenjë të thellë lidhjeje me tokën. Por përtej kësaj bukurie, Buzi përfaqëson një realitet kompleks: një krahinë me pasuri të mëdha natyrore dhe njerëzore, por njëkohësisht me sfida serioze në zhvillim, arsim dhe shëndetësi.

E rrethuar nga relievi malor dhe pranë masivit të Trebeshina, kjo zonë ka qenë historikisht e lidhur ngushtë me tokën dhe natyrën. Toka pjellore ka ushqyer breza të tërë, ndërsa burimet ujore kanë qenë themel i jetës dhe aktivitetit

bujqësor. Edhe sot, potenciali mbetet i jashtëzakonshëm: bujqësia bio, blegtoaria, kultivimi i bimëve medicinale dhe përpunimi i produkteve vendase janë mundësi reale për zhvillim ekonomik. Megjithatë, një pjesë e madhe e kësaj pasurie mbetet e pashfrytëzuar. Shumë toka janë lënë djerrë, jo për shkak të mungesës së vlerës, por për shkak të mungesës së fuqisë punëtore, investimeve dhe

tjetër pasuri të rëndësishme. Uji i pastër që buron në këtë zonë mund të shfrytëzohet për bujqësi moderne, për zhvillimin e agroturizmit apo edhe për produkte natyrore. Megjithatë, mungesa e infrastrukturës së ujitjes dhe projekteve konkrete e bën këtë potencial ende të pashfrytëzuar. Nëntoka e kësaj krahine mbetet një kapitull i hapur. Edhe pse nuk ka studime të detajuara, pozicioni gjeografik sug-

shfaqet si një nga rrugët më premtuese për zhvillim. Natyra e paprekur, ajri i pastër dhe autenticiteti i jetës rurale janë vlera që kërkohen gjithnjë e më shumë nga vizitorët. Buzi ka potencial të kthehet në një destinacion të turizmit natyror dhe kulturor, por kjo kërkon infrastrukturë, promovim dhe organizim.

Por zhvillimi i një zone nuk matet vetëm me burimet natyrore. Ai varet edhe nga cilësia e jetës së banorëve, ku arsimit dhe shëndetësisë luajnë një rol kyç.

Në fushën e arsimit, shkollat në zonat rurale si Buzi përballen me sfida të dukshme. Numri i nxënësve ka rënë ndjeshëm për shkak të emigrimit, ndërsa në shumë raste mësimi zhvillohet në klasa të kombinuara. Mungesa e mjeteve moderne didaktike dhe infrastruktura që ka nevojë për përmirësim e bëjnë procesin mësimor më të vështirë. Megjithatë, përkushtimi i mësuesve dhe dëshira e nxënësve për të mësuar mbeten një dritë shprese për të ardhmen. Edhe shërbimet shëndetësore janë të kufizuara.

Qendrat shëndetësore ofrojnë shërbime bazë, por mungesa e specialistëve dhe distanca nga qytetet e mëdha si Tepelenë e vështirësojnë aksesin në kujdes të specializuar. Për banorët, sidomos për të moshuarit, kjo përbën një sfidë të përditshme. Këto sfida – tkurja e popullsisë, mungesa e investimeve, infrastruktura e kufizuar dhe mungesa e mundësive ekonomike – krijojnë një rreth vicioz që e pengon zhvillimin e zonës.

Megjithatë, Buzi nuk është një zonë e varfër. Ai është një zonë e pasur që pret të menaxhohet dhe të zhvillohet me vizion. Me investime në bujqësi, në turizëm, në arsim dhe në shëndetësi, kjo krahinë mund të kthehet në një model të zhvillimit të qëndrueshëm rural.

E ardhmja e Buzit nuk varet nga ajo që i mungon, por nga mënyra se si shfrytëzon atë që ka. Sepse nëse toka punohet, uji menaxhohet, natyra ruhet dhe njerëzit mbështeten, atëherë kjo krahinë jo vetëm që do të mbijetojë, por do të lulëzojë.



tregut. Largimi i të rinjve drejt qyteteve apo emigrimit ka ndikuar drejtpërdrejt në këtë situatë, duke lënë pas një popullsi gjithnjë e më të plakur.

Burimet ujore përbëjnë një

jeron mundësi për burime natyrore, të cilat kërkojnë vëmendje dhe investime të kujdesshme për t'u zbuluar dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme.

Në këtë kuadër, turizmi

NË 100- VJETORIN E NJË RRUGE ENDE TË PA PËRFUNDUAR



Nga Xhezo Cana

Në pranverën e vitin 1926, pikërisht 100 vite më parë, qeveria shqiptare, me kryeministër Ahmet Zogun, vendosën një automobil që lidhte Beratin me Gjirokastrën. Rruga që do përshkruante autobusi ishte Berat-Gllavë-Buzi-Këlcyrë-Dragot-Lekël dhe Gjirokastrë. Gjithashtu linja do të ishte dhe në drejtim të kundër. Në Dragot autobusi do kalonte mbi një lundër (se ura u ndërtua në vitin 1936), ndërsa ura e Leklit ishte ndërtuar më parë. Problemi kryesor i kësaj rruge ishte ajo Gllavë-Buzi-Ballaban, ku për ndërtimin e saj u caktua popullsia e krahinës së Buzit dhe Krahësit. Rruga kishte filluar të hapej në kohën e Austro-Hungarisë 1916-1918 dhe me pas nga italianët, por, me kalimin e kohës, ishte rrënuar dhe nuk ishte i mundur kalimi i autobusit, pasi pushtuesit e kishin hapur dhe përdorur kryesisht për makinat e luftës. Për ndërtimin e kësaj rruge, Ministri i Punëve Botore, Musa Juka, (Që kishte qëllim ndërtimet e rrugëve, de-kovilve...), njofton prefekturën e Gjirokastrës dhe nënprefekturat vartëse siç ishte ajo e Tepelenës. (Prefekti i Gjirokastrës ishte Zef Kadare, ndërsa nënprefekti i Te-

pelenës ishte Lame Noçka nga Labova e Gjirokastrës). Në datën 23 janar 1926 në Tepelenë, qendër nënprefekturë, u thirrën 26 kryepleqtë e fshatrave të krahinës Buzi-Krahës dhe iu njoftua vendimi i qeverisë për ndërtimin e rrugës dhe detyrimet (forca e krahut), që kishte çdo fshat.




Në komunikimet midis Ministrisë, prefekturës Gjirokastrë dhe nënprefekturës Tepelenë, ishin caktuar punët që do bënte çdo fshat dhe numri i atyre që do punonin. Kishte një ligj në parlament (me propozim të asambleistit Sadulla Tepelenës) në viti 1920, pas Kongresit të Lushnjës, që detyronte çdo burrë në



moshën 18-60 vjeç të punonte një javë në vit punë vullnetare. Krahinës së Buzit iu ngarkua pjesa Ballaban-Buzi-Gllavë ku çdo dite punonin 300-400 punëtorë me kazma, lopata, karroca, vare, baromina etj. Ishin krijuar brigada që bënin murguri me specialistë (ustallarë të gurit), që merreshin nga fshatra të ndryshëm, por edhe urat e nevojshme. Rruga kishte si bazë atë që ishte hapur më parë, por

pati dhe devijime të ndryshme. Rruga u mbarua thuajse për tre muaj, sipas planit të caktuar dhe kjo linjë që lidhi qendrat e dy prefekturave; Berat dhe Gjirokastrë, ishte një sukses për kohën. Kishte raste kur persona të ndryshëm nuk shkonin në punë se mund të ishin në emigrim, të sëmurë apo arsye të tjera. Xhandarmëria u merre detyrimin në të holla për punën që duhet të bënin. Për të plotësuar punën e detyruar nënprefektura e Tepelenës kishte kontaktuar Shoqëria "Fiven Lilles" në Tepelenë. Po kështu u ndanë detyrat për rrugën Këlcyrë-Dragot-Urë e Leklit, ku punonin kryesisht të detyruarit e fshatrave Mezghoran, Peshtan, Dragot, Kodër dhe Lekël. Sipas statistikave të kohës çdo i detyruar duhet të bënte rreth 4-5 metra rrugë ku duhet të bëheshin kanalet dhe shtrimi me çakëll.

Kjo rrugë e asfaltuar pjesërisht në kohën e regjimit komunist u përdor për linjën automobilistike midis Beratit dhe Gjirokastrës. Pas viteve 1990 kjo rrugë që lidh Beratin dhe Këlcyrën ka qenë ashtu sikurse ishte ndërtuar para 100 vitesh. Vetëm para 4-5 vitesh është vendosur që kjo rrugë të shtrohet me asfalt dhe të bëhet sipas parametrevë të kohës. Ndërsa në vitin 1926 për 3 muaj u rindërtua dhe u vendos linja Berat-Gjirokastrë, tani ka kaluar rreth 3-4 vitesh dhe është bërë vetëm një pjesë e kësaj rruge. Ndërtimi i plotë i kësaj rruge do të jetë një shërbim i veçantë për krahinën e Buzit, e krahinës së Tafil Buzit, ku janë të ndërthurura bukuritë natyrore dhe ngjarjet historike.



EQEREM XHELILI - NJË PERSONALITET I NDËRTUAR MBI TRASHËGIMINË, PUNËN DHE GUXIMIN



Nga Feti ZENELI

Në historinë e njerëzimit, personalitetet e shquara rrallëherë shfaqen si figura të shkëputura nga rrënjët e tyre. Përkundrazi, ato janë produkt i një trashëgimie të caktuar familjare, kulturore dhe shoqërore, e cila ndikon ndjeshëm në formimin e karakterit dhe vlerave të tyre. Kjo ide përforcohet edhe nga thënia e historianit, matematikanit dhe filozofit skocez Tomas Karlile, i cili shprehet se: "Nuk kam dëgjuar kurrë për ndonjë njeri me vlera që të ketë lindur nga njerëz krejt të rëndomtë". Në këtë këndvështrim, çdo analizë e një individi me kontribute të rëndësishme kërkon domosdoshmërisht një ndalesë edhe tek origjina dhe formimi i tij i hershëm, për të kuptuar më mirë burimin e suksesit dhe arritjeve.

Në këtë kuadër, një figurë që meriton vëmendje është edhe ekonomisti Eqerem Xhelili, një emër i lidhur ngushtë me punën, përkushtimin dhe zhvillimin intelektual në Tepelenë e më gjerë. I lindur më 3 maj të vitit 1951 në fshatin Selckë e Madhe, të zonës së Buzit, ai përfaqëson jo vetëm një individ të suksesshëm, por edhe një shembull të ndikimit që mjedisi dhe trashëgimia familjare mund të kenë në formimin e një personaliteti të spikatur. Rrënjët e tij në një zonë me tradita të forta kulturore dhe njerëzore kanë shërbyer si një bazë e qëndrueshme për ndërtimin e karakterit dhe vizionit të tij në detyrat e ndryshme publike dhe private që ka kryer.

Një trajtim i tillë i çështjes synon të përcjell më qartë tek opinioni i sotëm shoqëror, se si ndërthuren trashëgimia, përkushtimi dhe rrethanat historike në krijimin e një personaliteti me vlera të qëndrueshme.

Ngjarja që lidh Panaritin e Korçës me Selckën e Tepelenës

Historia e një vendi nuk ndërtohet vetëm mbi ngjarje të mëdha politike apo figura të njohura kombëtare, por edhe mbi rrëfime të heshtura familjare, që mbartin në velvete frymën e kohës dhe virtytet e trashëguara ndër breza. Siç shprehet filozofi i njohur Aristoteli: "Ne jemi ajo që bëjmë vazhdimisht; përsosmëria, pra, nuk është një akt, por një zakon". Pikërisht ky zakon i përkushtimit, i punës dhe i mjeshtërisë është ai që lidh në mënyrë të padukshme, por të fuqishme, Panaritin e Korçës me Selckën e Tepelenës, duke krijuar një urë të qëndrueshme midis dy trevave dhe duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e një fisi.

Në thellësinë e viteve 1700, në Selckë të Tepelenës jetonte një burrë me peshë të veçantë në krahinë, Mato Latifi, i njohur për urtësinë, pasurinë dhe autoritetin e tij. Në një kohë të mbushur me trazira, varfëri dhe mungesë zhvillimi, ai arriti të ndërtonte dy banesa madhështore, të cilat jo vetëm që dalloheshin për përmasat e tyre të rralla, por edhe për vizionin që mishëronin. Me një sipërfaqe prej 400 m² secila, dy kate dhe rreth dyzet dhoma, këto ndërtime përfaqësonin jo thjesht strehë banimi, por një dëshmi të qartë të ambicies për të ndërtuar diçka që i rezistonte kohës. Për realizimin e këtij projekti, Mato Latifi solli një arkitekt italian, duke treguar kështu një hapje të pazakontë për kohën ndaj përvojave të huaja dhe një dëshirë për cilësi të lartë ndërtimi.

Megjithatë, ajo që e bën këtë histori veçanërisht domethënëse është përfshirja e ustallarëve nga Panariti i Korçës, një zonë e njohur për mjeshtria të aftë të ndërtimit. Këta burra, të pajisur me një znanat të trashëguar dhe të përpunuar me përkushtim, u bënë pjesë e këtij projekti të veçantë. Midis tyre spikat figura e kryeustait Adil, i cili nuk e pa Selckën thjesht si një vend pune të përkohshëm, por si një vend ku mund të ndërtonte jetën e tij. Vendimi i tij për të qëndruar aty shënon pikërisht pikën e fillimit

të një lidhjeje të re historike dhe familjare midis dy krahinave.

Adili ndërtoi shtëpinë e tij pranë rrugës së vjetër të karvaneve, një arterie e rëndësishme që lidhte juglindjen me Beratin dhe më tej, duke u bërë kështu pjesë e një rrjeti të gjallë ekonomik dhe kulturor. Kjo vendosje nuk ishte e rastësishme; ajo dëshmon për një zgjuarsiri praktike dhe një vizion për të qenë pranë lëvizjes, zhvillimit dhe shkëmbimit. Nga kjo rrënjë e re lindi Ahmeti, djali i tij, i cili do të trashëgonte jo vetëm zanatin e të atit, por edhe shpirtin e qëndresës dhe të guximit.

Por historia nuk ecën gjithmonë në rrugë të qeta. Rritja dhe përparimi i këtij fisi u shoqërua edhe me sfida të rënda, të



Eqerem Xhelili

nxitura nga xhelozia dhe ligësia njerëzore. Laknia e një hafijeje greke, Koloç Felahut, u kthye në një burim konflikti të ashpër. I shtyrë nga zilia për pasurinë dhe zhvillimin e të tjerëve, ai bashkëpunoi me andartët grekë për të shkatërruar atë që ishte ndërtime me mund dhe përkushtim. Djegia e shtëpive të Mato Latifit dhe të Ahmet Adilit nuk ishte thjesht një akt vandalizmi, por një përpjekje për të shuar një traditë dhe për të ndërprerë një vijimësi.

Megjithatë, siç shprehet Friedrich Niçe: "Ajo që nuk të vret, të bën më të fortë". Kjo thënie gjen një pasqyrim të qartë në reagimin e Ahmetit, i cili, përveçse u përball me padrejtësinë, ndërmori veprime për të mbrojtur familjen dhe nderin e tij. I detyruar nga rrethanat, ai u largua përkohësisht

drejt Çorrogjafit të Beratit, duke kërkuar siguri për jetën e djemve të tij. Ky largim nuk ishte një dorëzim, por një tërheqje e përkohshme për të ruajtur vazhdimësinë e familjes.

Me kalimin e kohës dhe ndryshimin e rrethanave, bijtë e Ahmetit, Xhelua dhe Qerimi, u kthyen në Selckë, tashmë të formuar si ustallarë të zotë, të denjë për traditën që përfaqësonin. Ata rindërtuan pak më në brendësi të fshatit, atë që ishte shkatërruar më në periferi të tij, duke ngritur dy shtëpi dykatëshe pranë njëra-tjetrës, një prej të cilave mbahet ende në këmbë edhe sot si dëshmi e qëndresës dhe e vazhdimësisë, kur shumica dërrmuese e shtëpive të Selckës, përfshi dhe ato të mëvonshme në kohë janë rrafshuar e praktisur pas viteve '90. Ky akt rindërtimi nuk ishte vetëm një nevojë praktike, por një simbol i fortë i ringritjes dhe i besimit në të ardhmen.

Fisi vazhdoi të zgjerohet dhe të forcohej, duke trashëguar brez pas brezi zanatin e muratorit. Pesë nga shtatë djemtë e Xhelos dhe Qerimit - Metja, Sulua, Demiri, Ismaili dhe Dilaveri - u bënë mjeshtër të shkëlqyer, duke ruajtur dhe zhvilluar më tej këtë traditë të vyer. Mes tyre, Ismaili, babai i Eqeremit, u dallua si figura më përfaqësuese, duke u vendosur në krye të kësaj trashëgimie profesionale dhe shpirtërore.

Vështirësitë e shkollimit dhe diplomimi si ekonomist i lartë

Në jetën e qdo njeriu, ka një ëndërr që i reziston kohës, varfërisë, pengesave dhe madje edhe padrejtësive. Jeta e Eqeremit është një dëshmi i gjallë e kësaj të vërtete, një rrugëtim i mbushur me vështirësi, por i udhëhequr nga një etje e pashuar për arsimim dhe përparim. Ajo nuk ishte thjesht një dëshirë për të mësuar, por një thirrje e brendshme, një dritë që i ndriçonte udhën edhe në errësirën e një fshati të thellë malor, ku dija vinte me hapa të ngadalë dhe sakrifica të mëdha.

I lindur në një fshat të largët malor si Selcka e Madhe, në një kohë kur mundësitë për shkollim ishin të kufizuara, Eqeremi u përball që herët me sfida që për shumikënd do të kishin qenë të pakapër-

cyeshme. Shkolla fillore ishte hapur vetëm pak vite para lindjes së tij, dhe kjo e bënte rrugën drejt dijes edhe më të vështirë. Megjithatë, ai nuk u tërhoq. Së bashku me bashkëmoshatarët e tij - Xhelal Xhafa, Safete Shehu, Sanije Latifi, Nerënxë Nuro dhe Xhelo Xhelili - ai ndau jo vetëm mësimet, por edhe përpjekjet e përditshme për të kapërcyer kufijtë që vendoste realiteti i asaj kohe.

Rruga drejt arsimit vijoi në fshatin fqinj Buz, më shumë se një orë larg në këmbë. Kjo rrugë, shpesh e vështirë dhe e lodhshme, veçanërisht në kushte të këqija atmosferike, ishte një provë e përditshme e vullnetit të tij. Megjithatë, ai dhe shokët e tij - Xhelali, Bekim e Izet Nuro, Hajdër Durmishi dhe Lenini Jaho - arritën ta përfundonin ciklin shtatëvjeçar, ku Eqeremi shquhej mbi të tjerët.


Megjithatë, suksesi i tij në mësim nuk mjaftoi për t'i hapur menjëherë dyert e arsimit të mesëm. Në vitin 1965, pavarësisht rezultateve të larta, atij nuk iu dha e drejta e studimit dhe u detyrua të fillonte punë në kooperativë. Kjo padrejtësi lidhej edhe me rrethanat familjare, pasi i ati, Ismail Xhelili, prej dhjetë vitesh nuk ishte bërë pjesë e kooperativës, duke i rezistuar presioneve të vazhdueshme shtetërore.

Në vitin 1967, kur zonës së Buzit iu dhanë disa të drejta studimi për në shkollën e mesme ekonomike "Kristo Isak" në Berat, u duk sikur më në fund po hapej një dritare shprese për Eqeremin. Ai u përfshi në listën e përzgjedhurve, së bashku me bashkëfshatarin e tij Hajdër Durmishi. Por edhe në këtë moment vendimtar, një pengesë e re u shfaq: kryetari i kooperativës Selckë, Laze Pasha, këmbënguli që emri i tij të hiqej nga lista, pikërisht për shkak të qëndrimit të të atit jashtë kooperativës.

Këtu del në skenë një ndërhyrje që nuk ishte thjesht dashamirësi, por një akt i mbështetur mbi kujtesën, mirënjohjen dhe logjikën njerëzore. Estref Jaho, pasardhës i trungut fisnor të Mato Latifit, ndërhyri në mbrojtje të Eqeremit. Ai nuk e pa çështjen

vijon në faqen 8

Poezi nga Bedri Kabasha



Nuk e kam takuar kurrë Bedriun. Vetëm mbiemri më shpuri në origjinën e vet, Zhapokikën. E ndoqa dikur në rrjetet sociale ku emri i tij rrinte sipër një poezie. Zakonisht unë lexoj një ose dy strofa. pastaj marr vendim për më tej. Shpesh e ndërpres aty leximin. Nuk më thanë gjë. Vargje prozaike, të stisura e të vendosura nën një metrikë së shumti foljore ca rima që të rutinojnë krejt dëshirën e madhe dhe ndjesinë që mund të kesh për poezinë. Por te Bedriu pashë diçka tjetër. Një varg i gjerë si hapësirat e livadheve të vendlindjes së tij, sepse ato hapësira ndihen së shumti faqe pas faqeje. Bedriu nuk vjen nga shkollat me orientim artin, por e do artin më shumë nga qindra të tjerë që e kanë atë shkollë. Ai ka atë mekanizmin e brendshëm të cilin ia ka dhënë origjina, historia, tradita e këngës, jeta e ky mekanizëm nuk e lë këtë njeri të dremisë. Ka një varg të plotë, e thotë

mendimin bukur, të qartë, nuk lë mendim në mes, nuk ka ekuivoke në vargjet e tij; aty gjen atë tharmin e mençurisë popullore, ku thërmija të tëra shfaqen lirshëm në brendësi të vargjeve të gjitha ciklet e saj. Ka një metrikë të bukur, të qartë, ndjek saktësisht rregullat e metrikës që një specialist më i mirë nga unë do t'i bënte dhe ndonjë sugjerim poetik, pa prishur kund ritmin, gjuhën e brendshme, veshjen artistike. Gjerësia tematike i ka dhënë dorë Bedriut të prekë gjithçka të jetës së tij. Të ndalet te një çast e të gjej edhe aty një trill poetik gjithnjë duke sjellë e risjellë në kujtesë jetën e djeshme, historinë, traditat e zonës, duke kërkuar aty njerëzoren, të bukurën, madhështoren, cilësi këto që koha nuk na i ka siguruar, por poeti i gjen te shpirti njerëzor. Natyra njerëzore, ku çibuku, urori, sofati, hiri i oxhakut, parmenda e kaut plak, furka e leshit që tjierr nëna ditët e saj të vështira; ja kjo është substanca e ciklit të poezive me tematikë vendlindjen. Natyrisht edhe Bedriu, si çdo poet,

e glorifikon vendlindjen. Ashtu kemi bërë të gjithë, por kjo nuk ia rrëzon vlerat e mëdha që poezia e tij shpalos në gjerësinë e saj. Në të gjithë vargëzimin e tij, Bedriu është besnik i vargut popullore tetëroksh e diku edhe gjashtëroksh. Hapi poetik shtrihet në kohë duke sjellë aty emra konkretë njerëzish që kanë bërë histori; ajo «Sofra Zhapoqiote» rreth së cilës nuk vjen vetëm jehona e kohës, por edhe ritmi i saj që kanë atë veshjen e duhur artistike. Vargu pasardhës shpesh është i paracaktuar, i dallueshëm e poeti mundohet ta përshatë atë duke u dhënë atyre atë veshje logjike, ku vijimësia e harmonia sigurohet vetëm nëse plotësojnë njeri-tjetrin pa stonuar. Vargu ka gjallërinë e duhur në epikën e lirikën e tij duke ruajtur gjithnjë fisnikërinë e vargut të rregullt të melosit popullor. Lexohet Bedriu në këtë libër. Nuk të jep mërzitje a besdisje, të ndjell varg pas vargu e kjo është tjetër vlerë e librit të Bedri Kabashës "Këngët e Zhapokikës"

ME EMRIN XHEMILE

Në Stamboll njëherë kur shkova muaji gusht sapo hyri. Në sarajet ku pushova, një turkishë më zuri syri.

Syri i saj ulli Beratit, më bëri për vete mua. Si lastar ishte nga shtati, shumë e bukur, s'ke ç'i thua.!

Shikimi atje më mbeti, M'u afrua me ngadalë. Se nga vija shpejt më pyeti, dhe shkëmbyem dy-tri fjalë.

-Kam ardhur nga Shqipëria dhe emrin ma thonë Daut. Nuk më mungon trimëria, me një fjalë jam "arnaut"

Turkja me emrin Xhemile, syrin me lezet ma shkel. I thashë- mos ma bëj me hile, se për ty bëhem bedel.

Në Bosfor xhiro me varka, dhe në kohën që u ndamë, i thashë- shihemi nga darka, ajo ma ktheu- në aksham.

Hëngrëm, pimë e vallëzuam pasytaj dolëm buzë detit. Ishte vonë ndaj u larguam tutje nga syri i milletit.

Me Xhemilen përqaftuar, trupi i saj digjej barut.

Kurse unë pak i nxituar -merre shtruar "arnaut!"

LINDUR E RRITUR NË VLORË

Mengjesi mbushur me vesë Del një lule manxuran Atje te qoshe bahçesë Syri për të po më qan.

Mike qerpikun kurorë, Sytë e tu më bënë për vete. Lindur e rritur në Vlorë, Sa të shkojnë k'to isharete.

Veshur hollë e allafërnga, Të mëndafshhtë e ke fustanin. Zhapone fare pa mënga, Përmbi gjoks të mban gjerdanin.

Flokët onde, dallgë deti, Bjonde të ngjyer në arë. Zili do t'i kish dhe mbreti, Shtat derdhur ujëvarë.

Thuam një fjalë, moj bejkushe, Diçka deshe të më thoshe. Buza jote moj zonjushë, Tamam si kumbull majhoshe

LONGARIN KAM ISHARETE

Gushëbardha me nishan, Si qiri maja e hundës. Më erdhi një ditë në stan, Më gjeti në kokë të shtrungës.

Kunadhja erdhi ngadalë, Për çudi, s'u ndjenë as qëntë.

Si një ëndërr mbi qepallë, Sa që u trazuan dhëntë.

Buzëkuqe, lule shege Nur i qeshur bijë valiu! Më vjen rrotull si shelege, Baluket ia merr veriu.

Me supe bën isharet Engjëllore shumë e butë Me bisht të syrit të vret Shejtanin në shishe fut !

I thashë, nga na vjen, moj mike ? Si u ngjite lart nga mali ? -Çava detin me kaikë, Për ty, more, çoban djali !

Folëm ç'kishim për të thënë Në karakoll, rrinte Belec. I shtrova bukë për të ngrënë : Djathë nape, brinjë keci.

Çobanesh, sua çobani ! Mori krrabën, përçoi deshtë ! Derdhur shtati, yll karvani, S'i dele shterpë në vjeshtë.


Shkula dhëntë për në lerë, I dhashë mikes dy mexhite. I thashë do të vij në derë S'të ndahem, moj gushë simite

S'duroj dot, më digjet khani, Longarin kam isharet. I bie sa nisem nga stanim Mikja në dritare pret.

EQEREM XHELILI - NJË PERSONALITET I NDËRTUAR MBI TRASHËGIMINË, PUNËN DHE GUXIMIN

Vijon nga faqja 7

vetëm në prizmin formal të rregullave të kohës dhe ndërhyrja e tij nuk u mbështet vetëm në ndjenjën e mirënjohjes. Ai solli edhe një argument praktik dhe bindës: Egeremi kishte punuar për një vit mes tyre në kooperativë, ndaj lejimi i tij për të vazhduar shkollën mund të ndikonte pozitivisht edhe në qën-



Shtëpia e Egeremit në Selckë e Madhe

drimin e të atit ndaj kooperativës. Dhe në fakt, siç e dëshmoi koha, kjo parashikim rezultoi i saktë - i ati u bë anëtar i kooperativës sapo Egeremi nisi shkollën.

Kjo ndërhyrje ishte një dëshmi se drejtësia shpesh kërkon guxim dhe kujtesë. Ajo ndryshoi rrjedhën e jetës së Egeremit, duke i hapur rrugën drejt arsimimit dhe një të ardhmeje më të mirë. Por telashet e shkollimit për Egeremin nuk kishin të sosur; ato i ngjani një dimri të gjatë që shtrihet mbi shpirtin dhe rrugën e njeriut, duke e vënë në provë jo vetëm trupin, por sidomos vullnetin. U nis për në Berat me shpresën e një fillimi të ri, me atë dritën e brendshme që ndez ëndrrat e të rinjve, por realiteti iu shfaq me një tjetër fytyrë: miratimi i Ministrisë së Arsimit për të dhe pesëmbëdhjetë shokët e tij nga zona e Buzit vononte pa afat, si një derë e mbyllur që nuk donte të hapet. Semestri i parë i shkollës kaloi i tëri në pritje, në një gjendje pezull midis shpresës dhe zhgënjimit. Ata ishin aty, në pragun e dijes, por jo ende brenda saj; jetonin në konvikt, ushqeheshin e flinin si nxënës, por nuk uleshin ende në bankat e shkollës, sikur fati t'i kishte lënë në një korridor të gjatë, ku koha rridhte pa mëshirë.

E megjithatë, në heshtjen e kësaj pritjeje të padrejtë, pijeje një forcë e brendshme. Pushimet e Vitit të Ri e kthyen Egeremin në fshatin e tij, në atë botë të thjeshtë e të pastër ku natyra dhe njeriu bashkëjetojnë në një harmoni të lashtë. Por edhe aty, me zjarrit të oxhakut dhe zërave të familjes, mendja e tij mbetej e lidhur me të ardhmen, me shkollën që ende nuk e kishte nisur. Dhe kur erdhi dita për t'u kthyer, natyra, si për ta sproruar deri në fund, shpërtheu në një stuhitë dëborë që mbuloi gjithçka. Rruga nacionale Këlcyre - Berat u bllokua; mjetet nuk qarkullonin më. Bota dukej e ngrihtë.

Por jo vullneti i tij.

Së bashku me Hajdërin, Egeremi vendosi të sfidonte të pamundurën. U nisën në këmbë

nga Selcka, duke ndjekur luginën e Lumit të Shalësit, që bashkohej me Osumin, si dy rrjedha fati që përplasen e ndërthuren. Ngjitja drejt Paraspuarit dhe dalja në Tërpan u shndërruan në një udhëtim epik, një kalvar të vërtetë përmes dëborës së dëndur. Gjashtë orë rrugë, ku çdo hap ishte një përpjekje, çdo frymëmarrje një sfidë, çdo çast një betejë me të ftohtin që depërtonte deri në palcë. Këpucët e lagura, trupat e mpirë, por shpirti i pathyer - ky ishte bilanci i asaj rrugë.

Dhe kur më në fund arritën në Tërpan, të lodhur deri në kufijtë e durimit njerëzor, pritën në heshtje, si dy silueta të ngjira në një peizazh dimëror. Fati, që shpesh i vë në provë më të fortët përpara se t'i shpërblejë, u shfaq në formën e një makine të vjetër me karrocieri të hapur. "Ngjituni sipër!", u tha shoferi. Ishte një thirrje e thjeshtë, por për ta do të që si një dorë e shtrirë nga vetë jeta.

Udhëtimi drejt Beratit vazhdoi nën furinë e erës së akullit, në atë hapësirë të zbuluar ku i ftohti nuk kishte mëshirë. Kur mbërritën, pas rreth një ore e gjysmë, ata nuk ishin më thjeshtë të lodhur - ishin kthyer në dy trupa të ngjirë, thuajse pa ndjesi, si dy trungje të hedhur nga stuhia. Me vështirësi zbritën nga



Egeremi me brigadierë e kooperativistë duke festuar rezultatet e arritura

makina dhe, duke u mbajtur pas njëri-tjetrit, arritën në konvikt.

Instinkti i parë i çoi drejt zjarrit, drejt ngrohtësisë që dukej si një shpëtim i menjëhershëm. Por aty ndërhyri urtësia njerëzore: një burrë me përvojë, vëllai i këngëtarit të njohur popullor Ndue Shyti, i ndaloi dhe i këshilloi të hiqnin rrobat e lagura e të mbështilleshin me batanije. Ishte një këshillë e thjeshtë, por jetëdhënëse - sepse jo çdo ngrohtësi të shpëton, dhe jo çdo ngutje të çon drejt së mirës. Ata e dëgjuan, dhe dalëngadalë, normaliteti u rikthyenë trupat e tyre të mpirë.

Dhe pikërisht atëherë, kur gjithçka dukej se kishte kaluar përmes një prove të skajshme, erdhi lajmi i shumëpritur: miratimi i Ministrisë së Arsimit kishte mbërritur. Si një agim pas një nate të gjatë dimri, më në fund, pas katër muajsh pritjeje, ata mund të uleshin në bankat e shkollës. Ishte një fitore e heshtur, por e thellë - një triumf i vullnetit mbi pengesën, i durimit mbi padrejtësinë.

Kjo ishte ndoshta sakrifica e fundit në rrugëtimin e tij shkollor. Nga shkolla "Kristo Isak" në Berat, rruga e Egeremit u shtri më tej, drejt Fakultetit të Ekonomisë Agrare

në ILB Kamëz, ku ai u dallua për përkushtim dhe rezultate të mira. Dhe kështu, ai djalë që dikur ecte nëpër dëborë me këpucë të lagura, mbërriti në një tjetër stacion të jetës, me një diplomë në dorë dhe me një horizont të ri përpara.

Tashmë, rrugëtimi i tij nuk ishte më drejt bankave të shkollës, por drejt jetës, drejt përgjegjësisë, drejt shërbimit. Sepse dija, në thelbin e saj, nuk është thjeshtë si stoli, por për t'u vënë në shërbim të njerëzve, siç tingëllonte atëherë si një betim i heshtur i brezave: "kudo ku ta lypë atdheu".

Historia e Egeremit mbetet kështu një himn i qëndresës njerëzore, një dëshmi se rrugët më të vështira janë shpesh ato që të çojnë më larg. Sepse, në fund, nuk janë pengesat ato që e përcaktojnë jetën e njeriut, por mënyra se si ai i kapërcen ato. Dhe ai që ecën përpara, edhe në dëborën më të madhe, e gjen gjithmonë pranverën.

Kryetari që vuri punën "rolin udhëheqës të partisë"

Në historinë e zhvillimit ekonomik, shpeshherë janë vënë përballë njëra-tjetrës dy botëkuptime: ai i drejtimit të centralizuar politiko-ideologjik dhe ai i menaxhimit të bazuar në meritë, dije dhe rezultate konkrete. Rrëfimi i përvoj-

duhur" ideologjike. Kjo përvojë u bë për të një mesim i vyer: jo vetëm për të kuptuar kufizimet e sistemit, por edhe për të ndërtuar më me kujdes marrëdhëniet me pushtetin politik. Sepse, siç shprehet filozofi Francis Bacon, "dija është fuqi" - por në një sistem të politizuar, kjo fuqi shpesh përplasat me interesa që nuk kanë lidhje me të vërtetën apo efikasitetin.

Kur Egeremi u zgjodh kryetar i kooperativës, ai u përball drejtpërdrejt me dogmën e "rolit udhëheqës të partisë". Por, ndryshe nga shumë të tjerë, ai nuk e pranoi këtë si një kufizim të pakapërcyeshëm. Brenda një kohe relativisht të shkurtër, ai arriti ta transformojë kooperativën përmes metodave bashkëkohore të drejtimit, duke vendosur në qendër punën e ndershme dhe rezultatin konkret. Rritja e vlerës së ditës së punës nga 7.5 lekë në 12.5 lekë brenda katër vitesh nuk ishte thjeshtë një tregues ekonomik; ajo ishte dëshmi e një filozofie të re menaxhimi.

Po cili ishte çelësi i këtij suksesi? Ai qëndronte në guximin për t'u distancuar nga praktikata e vjetra dhe për të sfiduar parimin dogmatik: "politika në plan të parë". Për Egeremin, në plan të parë ishte puna. Ai riktheu në pozicion drejtuese individë me përvojë dhe integritet, të cilët ishin larguar më parë për arsye ideologjike apo "njolla biografike", siç ishin në rastin konkret, Sabri Iliazi, Riza Pasha, Rushan Brahimi, Maliq Pasha, Estref Mema, etj. Ky veprim ishte një akt i qartë meritokracie në një sistem që shpesh e mohonte atë. Në këtë kontekst, vlen të kujtohet mendimi i Aristotelit: "Shteti më i mirë është ai ku sundon ligji dhe jo njerëzit." Egeremi, në mënyrën e tij, kërkonte të vendoste një formë "ligji" të bazuar në arsyen ekonomike dhe në drejtësinë profesionale, duke shmangur arbitraritetin politiko-ideologjik.



Egerem Xhelili, Spiro Cinga, Agim Xhelili dhe Kujtim Kreci

Por suksesi i tij nuk kaloi pa kundërshtime. Shkruar partiake, të paafat për ta sfiduar nëpërmjet rezultateve, iu drejtuan metodave të ulëta të letrave anonime. Një epizod i tillë, ku vetë sekretari i byrosë sajonte akuzë të pavërtetë, tregonte jo vetëm klimën e pasigurisë, por edhe frikën që kishte lindur ndaj një modeli të ri drejtimi. Reagimi i Egeremit - i drejtëpërdrejtë dhe i pa kompromis - ishte një shenjë e karakterit të tij dhe e bindjes se e vërteta nuk ka nevojë për maska. Ndërhyrja e mëvonshme e strukturave me të larta partiake për të korrigjuar këtë padrejtësi dhe ven-

dosja e një bashkëpunimi me konstruktiv me pasuesin e sekretarit të mëparshëm të byrosë së partisë dëshmon se, edhe brenda një sistemi të ngurtë, ekziston mundësia për përmirësim kur rezultatet janë të pamohueshme.

Një vend të veçantë në filozofinë drejtuese të Egeremit zinin edhe mekanizatorët e ish-SMT-së - ata njerëz të heshtur të punës, që me duart e tyre mbanin gjallë ritmin e prodhimit dhe i jepnin tokës frymën e pasurimit. Ai i vlerësonte



Në një takim me Lenka Çukon dhe udhëheqës lokal

jo thjeshtë si mekanizatorë, por si shtylla të vërteta të ekonomisë bujqësore. Emra të tillë si ai i Bekdash Bakiajt, Novruz Pashës, Syrja Kalem, Veli Xhelili, Riza Zaçes, nuk përfaqësonin vetëm individë, por një model pune të ndërtuar mbi përkushtimin, përvojën dhe ndershmërinë. Në sytë e tij, ata ishin dëshmia se zhvillimi nuk buron vetëm nga zyrat dhe planet në letër, por nga djersa e njerëzve që punojnë në terren. Siç shprehet Leon Tolstoi, "forca e vërtetë e një shoqërie qëndron tek njerëzit e saj të thjeshtë", dhe Egeremi e mishëronte këtë bindje në mënyrën se si i trajtonte dhe i vlerësonte këta punëtorë të specializuar.

Në këtë rrjedhë, ngjitja e tij në vitin 1987 në detyrën e nënkryetarit të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tepelenë nuk ishte thjeshtë një hap karriere, por një moment simbolik: njohja e një modeli drejtimi që vinte në qendër

parë. Në një mbledhje të organizatës bazë të partisë të komitetit ekzekutiv, ai artikuloi hapur një qëndrim që për kohën ishte sa i guximshëm, aq edhe i rrezikshëm: çështjet e rëndësishme, sipas tij, duhej të diskutoheshin në mënyrë profesionale dhe institucionale, jo të shndërroheshin në spektakle formale mbledhjesh. Këto fjalë ranë si një gur në ujë të qetë - tronditën të pranishmit dhe u përhapën si jehonë në strukturat partiake të rrethit.

Pasojat nuk vonuan. Edhe pse nuk u ndëshkua në mënyrë të drejtpërdrejtë, mekanizmi i asaj kohe vepronte ndryshe - i butë në formë, por i ashpër në përmbajtje. Siç thuhej shpesh, "të vriste me pambuk": të largonte nga qendra e vendimmarrjes duke të zhvendosur në detyra më të ulëta, duke zbehur ndikimin pa bërë zhurmë. Kështu ndodhi edhe me Egeremin, i cili u ul në detyrë, jo për mungesë aftësie, por për tepëriçë sinjeraliteti dhe pavarësie mendimi.

E megjithatë, kjo nuk e ndryshoi thelbin e tij. Ai mbeti i majtë në bindje, por jo në kuptimin dogmatik të fjalës; përkundrazi, ai ishte kritik ndaj asaj që vetë e quante, shpesh nën zë, "struktura parazitare" - organizma që më shumë pengonin sesa ndihmonin zhvillimin. Kjo vetëdije e bëri të qëndrojë larg politikës aktive edhe pas ndryshimit të sistemit, në një kohë kur shumë të tjerë rendnin drejt pushtetit. Ai shihte me qartësi se si, në vend të meritës, shpesh ngriheshin në detyra të larta individë të paafat e të padinjëtkës, duke e kthyer tranzicionin në një zhgënjim të heshtur për ata që besonin tek vlerat.

Në vend që të bëhej pjesë e kësaj loje, Egeremi zgjodhi rrugën e profesionistit. Ai e mbylli karrierën aty ku e kishte nisur me pasion: në fushën e dijes dhe të punës konkrete. Si specialist audit në Ministrinë e Energjitikës, ai vijoi të japë kontributin e tij deri në daljen në pension në vitin 2017, duke mbetur besnik ndaj parimeve që e kishin udhëhequr gjithë jetën - ndershmërisë, profesionalizmit dhe përgjegjësisë.

Në fund, historia e tij nuk është thjeshtë një biografi personale, por një refleksion mbi një të vërtetë universale: sistemet ndryshojnë, strukturat rrëzohen e rindërtohen, por vlerat e vërteta mbeten. Siç do të shprehej Albert Kamy, "integriteti nuk ka nevojë për rregulla" - ai është një zgjedhje e përditshme. Dhe Egeremi, në heshtje e pa bujë, zgjodhi ta jetojë këtë të vërtetë deri në fund të jetës së tij aktive.

Gazeta
"Trebeshtina"
Kryeredaktori,
Veledin_Durmishi@yahoo.com
Marketing: Asim BRAHIMI

Bashkëpunëtorët tanë në rrethe:
Delvinë, Fatmir Pushi
Durrës, Besnik Hoxha
Tepelenë, Bedri Serjani, Gëzim G. Ajdini,
Gëzim Q. Ajdini

Gjirokastrë, Lavdi Hasani, Altin Goxhaj
Ksamil, Resul Pushi, Neim Murto
Berat, Ferdinand Mimani, Syrja Kalem
Tiranë, Feti Zeneli, Roshi Ajdini, Hava
Mihasi Muçollari
Sarandë, Medi Kalem